



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve

Data: 03.04.2023

Nr: 43

Ora: 12:30

VENDIM

**PËR SHQYRTIMIN E KËRKESËS ANKIMORE NR. 39 DATË 29.03.2023, TË DEPOZITUAR NGA
SUBJEKTI ZGJEDHOR "NISMA THURJE"**

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve në mbledhjen e datës 03.04.2023, me pjesëmarrjen e:

Elvis ÇEFA - **Relator**
Elvin LAKO - **Anëtar**
Ilirjan RUSMALI - **Anëtar**
Koli BELE - **Anëtar**
Ledio BRAHO - **Anëtar**

Shqyrtoi çështjen me:

KËRKUES: Partia "Nisma Thurje", përfaqësuar nga kryetari z. Endrit Shabani

OBJEKT: Kundërshtim i vendimit nr. 10, datë 28.03.2023, të KZAZ-së nr. 82, të bashkisë Dropull, Gjirokastër

BAZË LIGJORE: Nenet 21, pika 1, shkronja "b", 133-136 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar

Rrethanat e çështjes:

1. Presidenti i Republikës së Shqipërisë, me Dekretin nr. 13864, datë 24.10.2022, ka caktuar datën 14 maj 2023, si datën e zhvillimit të zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore.
2. Në zbatim të parashikimeve të nenit 70 të Kodit Zgjedhor, si dhe të Udhëzimit nr. 01, datë 18.01.2023 për "Përcaktimin e rregullave për depozitimin dhe verifikimin e dokumentacionit të kandidimit, afatet për publikimin e listave të kandidatëve dhe miratimin e modeleve të kandidimit për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore" të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, partia "Nisma Thurje" ka depozituar në datën 27.03.2023, në KZAZ nr. 90 të bashkisë Dropull të qarkut Gjirokastrë, dokumentacionin e z. Kosta Garo për tu regjistruar si kandidat për Kryetar bashkie i subjektit zgjedhor "Nisma Thurje".
3. Me vendimin nr. 10, datë 28.03.2023, KZAZ nr. 82 e bashkisë Dropull, në qarkun e Gjirokastrës, vendosi refuzimin e kërkesës për regjistrimin si kandidat të z. Kosta Garo, për shkak të mungesës së dokumentacionit të rregullt.
4. Kundër këtij vendimi ka paraqitur kërkesë ankimore partia "Nisma Thurje", ku pretendon se:
 - Dokumentet e dorëzuara nga ana e subjektit janë të plota, të dorëzuara brenda afatit ligjor dhe në përputhje me kërkesat ligjore;
 - Nëse KZAZ do të kishte konstatuar mungesë dokumentacioni, do të duhej ta kishte pasqyruar këtë fakt në procesverbalin e dorëzimit të dokumenteve të kandidimit, gjë që nuk ka ndodhur;
 - Mosregjistrimi i kandidatit Kosta Garo është i pajustificuar nga KZAZ nr. 82, anëtarët e së cilit nuk kanë dhënë asnjë argument për vendimmarrjen e tyre;
 - Kërkojnë regjistrimin e kandidatit Kosta Garo, si kandidat i subjektit "Nisma Thurje", për kryetar bashkie në bashkinë Dropull.
5. Kërkesa ankimore iu paraqit KAS-it, i cili vendosi pranimin për shqyrtim të saj me relator z. Elvis Çefa. KAS-i caktoi seancën e shqyrtimit në datën 03.04.2023, ora 12:30.

6. KAS-i mori në shqyrtim dhe administroi:

- Kërkesën ankimore nr. 39, datë 29.03.2023
- Vendimin nr. 10 datë 28.03.2023 të KZAZ nr. 82 Dropull
- Procesverbalin e mbajtur nga anëtarët e KZAZ nr. 82
- Raportin e datës 25.03.2023, të monitoruesit z. Arjan Gjini

Në përfundim të shqyrtimit administrativ dhe të vlerësimit të provave dhe pretendimeve të palëve,

KAS-i konstatoi:

1. Subjekti zgjedhor “Nisma Thurje” dhe anëtarët e KZAZ-së nr. 82 të Bashkisë Dropull paraqitën përpara KAS-it dy rrëfime të kundërta lidhur me zbatimin e procedurës për regjistrim të kandidatit të këtij subjekti për kryetar të Bashkisë Dropull, z. Kosta Garo. Subjekti deklaroi se dorëzimi i dokumentacionit të kandidimit ishte bërë dhe ishte pranuar më datë 27.03.2023 pa asnjë mangësi, kurse KZAZ-ja nr. 82 pretendoi se kishte konstatuar mangësi të fotokopjeve të letërnjoftimeve në listat me nënshkrimet mbështetëse të zgjedhësve dhe, për këtë arsye, i kishte lënë kandidatit afat për dorëzimin e dokumentacionit që mungonte, deri më datë 28.03.2023, ora 18:00.
2. Subjekti dhe kandidati e mbështesnin deklarinimin e tyre tek prova shkresore “Procesverbali i dorëzimit të dokumentave të kandidimit” (procesverbali model KQZ-00-31), që mban datën 27.03.2023 dhe është nënshkruar nga Kosta Garo, në cilësinë e dorëzuesit të dokumenteve dhe nga Gligor Dushi, në cilësinë e marrësit në dorëzim për KZAZ. Procesverbali është i hartuar në formën e një formulari dhe ka në krah të shënuar me shenjën (X) këto dokumente:
 1. formular për mbledhjen e nënshkrimeve të zgjedhësve për mbështetje kandidati Model KQZ-04-01;
 2. Kërkesë për regjistrimin e kandidatit për Kryetar Bashkie propozuar nga parti politike/koalicion Model KQZ-04-06;
 3. Deklaratë e kandidatit për hapje llogarie bankare të posaçme Model KQZ-04-08;

4. Deklaratë për pranimin e kandidimit Model KQZ-04-09;
 5. Jetëshkrimi i kandidatit Model KQZ-04-10;
 6. formular i vetëdeklarimit;
 7. Dokumentin identifikues për kandidatin për kryetar bashkie/anëtar në këshillin bashkiak.
3. KZAZ-ja e mbështet pretendimin e saj tek shënimet në librin e protokollit të mbledhjeve të KZAZ-së nr. 82, përkatësisht shënimi i datës 27.03.2023, ora 00:20, në të cilin shkruhet se *“pasi u konstatuan mungesa në dokumentacionin dhe në mungesë të sekretarit me vulën përkatëse iu komunikua kandidatit, z. Kosta Garo të plotësojë sipas dispozitave të kodit zgjedhor kartat e identitetit ID (Fotokopje) me nënshkrimet e zgjedhësve brenda orës 18:00 për të plotësuar dokumentacionin datë 28.03.2023”*, si dhe shënimi i datës 28.03.2023, ora 20:00, në të cilin, ndër të tjera, shkruhet se *“Stafi i KZAZ priti deri në orën 20:55 dhe përsëri subjekti nuk paraqiti dokumentat ID dhe nënshkrimet. Për këtë arsye KZAZ mori vendim të mospranimi të kandidaturës së subjektit “Nisma Thurje” për kandidat për kryetar të bashkisë në zgjedhjet vendore 14 maj 2023 për arsye të mungesës së dokumentacionit”*. Procesverbali është nënshkruar në çdo faqe nga të gjithë anëtarët në detyrë të KZAZ-së (katër anëtarë), por nuk është vëlluar për shkak të mungesës së sekretarit të KZAZ-së.
4. Procesverbali model KQZ-00-31 është dokument zyrtar që pasqyron dorëzimin e dokumentacionit të kandidimit, por nuk përmban asnjë të dhënë lidhur me shqyrtimin tij. Për marrjen në dorëzim të dokumenteve KZAZ-ja cakton një përfaqësues, kurse shqyrtimin e tyre e bën si trupë, në harkun e tri ditëve nga momenti i dorëzimit. Marrja në dorëzim finalizohet me procesverbalin model KQZ-00-31, kurse shqyrtimi finalizohet me vendimin model KQZ-01-19. Në rastin e ankuesit, shqyrtimi është finalizuar me vendimin nr. 10, datë 28.03.2023, ora 21:23.
5. Kompetencën për kthimin për plotësim të dokumentacionit nuk e ka përfaqësuesi i KZAZ-së që merr në dorëzim dokumentacionin, por e ka KZAZ-ja si trupë. Kthimi për plotësim nuk formalizohet me një akt të caktuar, por formalizohet me një shënim në librin e protokollit të

mbledhjeve të KZAZ-së. Në çështjen objekt shqyrtimi, ky shënim është bërë në librin e protokollit të mbledhjeve të KZAZ-së, pas mesnatës së datës 27.03.2023.

6. Procesverbali model KQZ-00-31 konfirmon dorëzimin e formularit për mbledhjen e nënshkrimeve të zgjedhësve për mbështetje kandidati, por nuk jep asnjë të dhënë për mënyrën e plotësimit të tij, për përmbajtjen apo për dokumentacionin shoqërues. Të gjitha këto të dhëna qëmtohen vetëm në procedurë shqyrtimi. Gjatë shqyrtimit verifikohet numri i zgjedhësve me nënshkrimet mbështetëse, verifikohen të dhënat e tyre personale, përfshirë të dhënat e letërnjoftimit, përkatësia e tyre në listën e zgjedhësve, në tërësi rregullsia dhe plotësia e formularit. Prandaj pretendimi se dorëzimi/pranimi i dokumentacionit rrëzon shkresërisht pretendimin se dokumentacioni ka qenë i paplotë dhe i parregullt është i papranueshëm në pikpamje proceduriale.
7. Procesverbali model KQZ-00-31 nuk ka asnjë rubrikë ku të shënohet se është bërë dorëzimi i fotokopjeve të letërnjoftimeve të zgjedhësve që mbështesin kandidimin. Kjo do të thotë për ankuesin, se procesverbali model KQZ-00-31 nuk mund të përdoret prej tij si provë pozitive se ai ka bërë faktikisht dorëzimin fotokopjeve të letërnjoftimeve të zgjedhësve, sepse procesverbali nuk e përmban këtë informacion.
8. Ankuesi kundërshtoi në seancë besueshmërinë e shënimeve në librin e protokollit të mbledhjeve të KZAZ-së nr. 82, për shkak se KZAZ-ja funksionon përkohësisht si trupë politikisht e njëanshme dhe i mungon sekretari që të mbajë përgjegjësi dhe të certifikojë shënimet në librin e protokollit të mbledhjeve. Kjo përbën një situatë faktike që është e pavarur nga vullneti i KZAZ-së, për të cilën anëtarët në detyrë nuk mbajnë përgjegjësi as për krijimin, as për ekzistencën e saj. Kjo situatë gjithashtu nuk ka lidhje as me ankuesin dhe as ka ardhur për shkak të procedurës së regjistrimit të kandidatit të tij.
9. Besueshmëria publike në veprimtarinë e administratës zgjedhore mbështetet sipas Kodit Zgjedhor në dy shtylla. E para është balanca politike në kompozimin e trupës, kurse e dyta është e drejta për akses e subjekteve zgjedhore dhe transparenca e veprimtarisë. E drejta për akses përfshin jo vetëm të drejtën për të marrë pjesë në mbledhjet e organeve të administratës zgjedhore, apo për të vëzhguar zbatimin e procedurave ligjore nga ana e tyre. E drejta për akses

shtrihet edhe mbi dokumentacionin që administrata zgjedhore prodhon. Ajo përfshin edhe të drejtën për të bërë kontestime dhe për të kërkuar që kontestimet të shënohen në dokumentacionin e organit të administratës zgjedhore.

10. E drejta për akses nuk është kusht për ushtrimin e veprimtarisë së organeve të administratës zgjedhore. Ajo është garanci që jepet nga ligji, por vihet në zbatim nga vetë subjekti i interesuar. Nëse subjekti i interesuar i rri larg procedurave, nuk merr pjesë në mbledhje dhe nuk është proaktiv kur trupa shqyrton kërkesat e tij, atëherë pretendimet e tij për shkelje gjatë zbatimit të procedurave mund të merren veçse me rezervë.
11. Mungesa e lidhjes shkakësore midis procesit të regjistrimit të kandidatëve dhe përbërjes aktuale të pabalancuar të KZAZ-së nr. 82, si dhe mungesa e kandidatit ose e përfaqësuesve të autorizuar të subjektit përgjatë procedurës së shqyrtimit të dokumenteve të kandidimit e bëjnë të pamundur mbajtjen në këmbë të pretendimit për veprimtari “konspirative” të KZAZ-së nr. 82.
12. Gjithësesi, KAS-i thelloi hetimin edhe në këtë drejtim, duke thirrur të dëshmojë z. Arjan Gjini, i cili është monitorues i KQZ-së për zonën, njëkohësisht trainer i KQZ-së për administratën zgjedhore. Sipas dëshmisë së dhënë para KAS-it, z. Gjini ka monitoruar veprimtarinë e KZAZ-së nr. 82 përgjatë procedurave të regjistrimit të datës 28.03.2023 dhe ka mundur të konstatojë personalisht mungesën e dokumentacionit shoqëruar të formularit për mbledhjen e nënshkrimeve të zgjedhësve për mbështetje kandidati (mungesën e letërnjoftimeve). Z. Gjini ishte informuar nga anëtarët e KZAZ-së, se ishin në pritje të subjektit zgjedhor “Nisma Thurje” për plotësimin e dokumentacionit, si dhe kishte asistuar teksa KZAZ-ja bënte veprimet e përshkruara në librin e protokollit për verifikimin e listës së zgjedhësve mbështetës të kandidatit.
13. Dëshmia e z. Gjini konfirmon në mënyrë të besueshme shënimet e KZAZ-së në librin e protokollit. Vetë z. Gjini rezulton dëshmitar i besueshëm, sepse ai më datë 28.03.2023 ka bërë raportim në KQZ për gjetjet nga monitorimi në këtë KZAZ, duke komentuar për ankuesin se *“u konstatua se dokumentat e kandidatit të “Nisma Thurje” kishin mangësi në përmbajtje”*,

konstatim qe është depozituar në KQZ rreth orës 15:00 të datës 28.03.2023, kohë përpara se KZAZ-ja të merrte vendimin për mospranimin e dokumentave të kandidimit.

14. KZAZ-ja nr. 82 i ka akorduar ankuesit 24 orë afat për plotësimin e dokumentacionit, sikurse provohet nga libri i protokollit të mbledhjeve të KZAZ-së. Kodi Zgjedhor ka parashikuar një afat maksimal për kryerjen e plotësimeve dhe korrigjimeve në dokumentat e kandidimit, i cili nuk mund të shkojë përtej 45 ditëve përpara datës së zgjedhjeve, d.m.th. jo më vonë se data 30 mars 2023. Udhëzimi Komisionerit nr.1, datë 18.01.2023 nuk ka të përcaktuar si akordohet ky afat rast pas rasti. Çështja mbetet diskrecion i KZAZ-së, por nuk mund të jetë ushtrim arbitrariteti. Koha në dispozicion të subjektit për korrigjime dhe plotësime duhet të jetë racionalisht e mjaftueshme për kryerjen e tyre. Kjo do të thote, se afati caktohet në bashkëpunim me palën e interesuar dhe me qëllimin e mirë që detyra e lënë të plotësohet saktësisht dhe me sukses. Afati i lënë prej 24 orësh në rastin konkret nuk mund të konsiderohet arbitrar nga ana e KAS-it, sepse me të nuk u lidh asnjë pretendim konkret në seancë.
15. KZAZ-ja nr. 82 ka verifikuar saktësinë e listës së zgjedhësve mbështetës të kandidatit dhe ka konstatuar parregullsi në të dhënat e 17 zgjedhësve. Ky konstatim gjithashtu është fiksuar në librin e protokollit të mbledhjeve të KZAZ-së, me shënimet përkatëse për secilin prej tyre. Verifikimi i të dhënave është bërë nëpërmjet thirrjeve telefonike. Nga këto shënime del se një pjesë e zgjedhësve kanë numra telefoni të pasaktë, për një pjesë tjetër nuk korrespondon identiteti i zgjedhësit me identitetin e mbajtësit të telefonit, për një pjesë të dhënat janë të gabuara, sikurse ka midis tyre që nuk janë banorë të bashkisë Dropull. Kryetari i KZAZ-së ngriti pretendimin se verifikimi provonte se personat e verifikuar nuk ishin zgjedhës të zonës dhe, për pasojë lista duhet të refuzohet për shkak numri i mbështetësve bie nën numrin minimal ligjor.
16. KZAZ-ja kryen procedurë verifikimi rastësor për emrat në listë, me qëllim që vertetojë nëse zgjedhësit i përkasin bashkisë, apo jo. Rregullat e KQZ-së (udhëzimi i Komisionerit nr.1, datë 18.01.2023) nuk kanë përcaktuar procedurën konkrete të verifikimit, duke i lënë dorë të lirë KZAZ-ve që të bëjnë verifikimin si ta gjykojnë ato më të përshtatshme. KZAZ-ja nr. 82 nuk disponon ende mbi listat e zgjedhësve të zonës zgjedhore, si dhe nuk mund të bëjë verifikimin, duke konsultuar listën e zgjedhësve nga adresa ëëë.kqz.gov.al, sepse nuk ka pasur të përfshirë

atësinë tek identitetit i zgjedhësve mbështetës. Rruga më e saktë për të do ishte të bënte verifikimin nëpërmjet zyrës së gjendjes civile të bashkisë Dropull.

17. Metoda që ka zgjedhur KZAZ-ja nr. 82 është e padobishme për qëllimet e verifikimit, sepse asnjë nga të dhënat që ajo ka përftuar nga thirrjet telefonike nuk provon nëse zgjedhësit bëjnë pjesë në listën e zgjedhësve të zonës, apo jo. Anëtarët e KZAZ-së shpjeguan se, për shkak të natyrës së zonës zgjedhore me numër të vogël zgjedhësish, ata i njihnin personalisht nënshkruarit dhe kishin bindjen se një numër i tyre nuk ishin banorë të zonës, ose jetonin familjarisht jashtë vendit dhe për këtë shkak kishte dyshime nëse ata ishin firmëtarët e listës së dorëzuar në datën 27.03.2023 si dhe fotove/fotokopjeve të kartave ID dhe pasaportave në një datë të mëvonshme.
18. KAS-i nuk mund t'i verifikonte në mënyrë të thelluar këto pretendime në procedurën e shqyrtimit administrativ. Prandaj KAS-i çmon se të dhënat e përfthuara nga verifikimi i kryer nga KZAZ-ja nuk mund të çojnë në refuzimin e kandidimit për shkak mangësive të listës me emrat e zgjedhësve mbështetës të kandidatit z. Kosta Garo.
19. Vendimi nr. 10 i KZAZ-së nr. 82, datë 28.03.2023 ka refuzuar regjistrimin për mungesë të dokumentacionit shoqëruar të listës me emrat e zgjedhësve mbështetës dhe për mosplotësim të tij në afatin e caktuar nga KZAZ-ja nr. 82. Shkronja "g", e nenit 3, të udhëzimit të Komisionerit nr. 1, datë 18.01.2023 kërkon në mënyrë taksative që *"formularit tip të nënshkruar nga zgjedhësit e zonës përkatëse që mbështesin kandidatin/partinë/koalicionin, në përputhje me nenet 68, 70 dhe 71, të Kodit Zgjedhor sipas Modelit KQZ-04-01" t'i bashkëlidhet "fotokopja e dokumentit të identifikimit të vlefshëm, të nënshkruar nga çdo zgjedhës"*. Kjo kërkesë provohet se nuk është plotësuar nga subjekti dhe/ose kandidati edhe pas afatit të vendosur nga KZAZ-ja. Ky fakt i provuar e bën vendimin nr. 10 të KZAZ-së nr. 82 të ligjshëm.
20. Në procedurën e shqyrtimit të ankimimit administrativ, KAS-i ka detyrë të shqyrtojë ligjëshmërinë e veprimeve të KZAZ-së, jo të marrë dhe ushtrojë kompetencat në emër të saj. KAS-i ka kompetencë të vendosë prishjen e vendimeve të paligjshme të KZAZ-ve, jo të vendimeve që janë marrë në përputhje me ligjin dhe me kompetencën institucionale të tyre.

Për këtë arsye, KAS-i duhet të lërë në fuqi vendimin nr. 10 të KZAZ-së nr. 82, sepse ai është vendim i marrë në përputhje me ligjin dhe kompetencën lëndore të KZAZ-së.

PËR KËTO ARSYE:

Mbështetur në shkronjën “b”, të pikës 1, të nenit 143 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me shumicë votash, KAS

V E N D O S I:

1. Rrëzimin e kërkesës ankimore nr. 39, datë 29.03.2023 të paraqitur nga Partia “Nisma Thurje”.
2. Lënien në fuqi të vendimit nr. 10, datë 28.03.2023 të KZAZ nr. 82, Bashkia Dropull.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor Gjyqësor pranë Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, brenda 5 ditëve nga shpallja e tij.

Elvis ÇEFA	-	Relator	(Kundër)
Elvin LAKO	-	Anëtar	
Ilirjan RUSMALI	-	Anëtar	
Koli BELE	-	Anëtar	
Ledio BRAHO	-	Anëtar	(Kundër)

MENDIM PAKICE

1. Në shqyrtimin e kërkesës ankimore nr. 39 të paraqitur nga subjekti zgjedhor “Nisma Thurje” dhe kandidati i saj për kryetar të Bashkisë Dropull, z. Kosta Garo, me objekt *“Kundërshtimin e vendimit nr. 10, datë 28.03.2023 të KZAZ Nr. 82”*, ne, anëtarët në pakicë, duke mos qenë dakord me konkluzionet dhe argumentet e parashtruara nga shumica e anëtarëve të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve (në vijim KAS) jemi të mendimit se KAS duhet të pranonte ankimin e paraqitur nga subjekti zgjedhor “Nisma Thurje” dhe kandidati i saj për kryetar të Bashkisë Dropull, z. Kosta Garo dhe për rrjedhojë të ndryshonte vendimin nr. 10, datë 28.03.2023 të KZAZ Nr. 82, ndaj paraqesim në vijim argumentet tona për këtë qëndrim.
2. Rezulton i provuar fakti se partia politike “Nisma Thurje”, me vendimin nr. 123, datë 08.03.2023 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, është regjistruar si subjekt zgjedhor në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023.
3. Në vijim të regjistrimit si subjekt zgjedhor, ankimesi “Nisma Thurje”, në zbatim të paragrafit të dytë të nenit 67 pika 1 të K.Zgjedhor që parashikon se *“Për zgjedhjet e organeve të qeverisjes vendore, kandidati për kryetar të njësisë së qeverisjes vendore dhe lista e kandidatëve për këshillat vendorë regjistrohen në KZAZ-në që mbulon njësinë e qeverisjes vendore brenda afatit të përcaktuar në këtë pikë”*, i është drejtuar KZAZ nr 82, për të regjistruar z. Kosta Garo si kandidat për kryetar të Bashkisë Dropull.
4. Duke qenë se subjekti zgjedhor “Nisma Thurje” nuk zotëron asnjë mandat në Kuvend apo në organet e qeverisjes vendore (kryetar bashkie ose anëtar i këshillit bashkiak) të Bashkisë Dropull, në zbatim të nenit 68 pika 2 të K.Zgjedhor që parashikon ndër të tjera se *“2. Kandidatët për organet e njësisë së qeverisjes vendore, të paraqitur nga partitë politike, të cilat nuk zotërojnë asnjë mandat në Kuvend ose në organet e njësisë përkatëse të qeverisjes vendore, duhet të mbështeten nga jo më pak se 1 për qind e zgjedhësve të asaj njësie, por, në çdo rast, jo më shumë se 3,000 dhe jo më pak se 50 zgjedhës”*, përveç pjesës tjetër të dokumentacionit që kërkohet nga neni 72 i K.Zgjedhor, ka depozituar pranë KZAZ nr. 82 edhe një listë mbështetësish prej 215 zgjedhësish (jo më pak se 1% e zgjedhësve të Bashkisë Dropull që ka 20,000 zgjedhës).

5. Shumica e anëtarëve të KAS, kanë pranuar qëndrimet e KZAZ të pasqyruara në “Librin e Protokollit të Mbledhjeve” të kësaj KZAZ, duke ju referuar më konkretisht shënimit të datës 27.03.2023, ora 00:20 me përmbajtje “... pasi u konstatuan mungesa në dokumentacionin dhe në mungesë të sekretarit me vulën përkatëse iu komunikua kandidatit, z. Kosta Garo të plotësojë sipas dispozitave të kodit zgjedhor kartat e identitetit ID (Fotokopje) me nënshkrimet e zgjedhësve brenda orës 18:00 për të plotësuar dokumentacionin datë 28.03.2023” dhe shënimit të datës 28.03.2023, ora 20:00 me përmbajtje “Stafi i KZAZ priti deri në orën 20:55 dhe përsëri subjekti nuk paraqiti dokumentat ID dhe nënshkrimet. Për këtë arsye KZAZ mori vendim të mospranimi të kandidaturës së subjektit “Nisma Thurje” për kandidat për kryetar të bashkisë në zgjedhjet vendore 14 maj 2023 për arsye të mungesës së dokumentacionit”.
6. Për ne anëtarët në pakicë, argumenti i parë mbi të cilin e konsiderojmë të pabazuar vendimin e KZAZ nr. 82 objekt i këtij shqyrtimi administrativ, që ka të bëjë me mosdepozitim të fotokopjes së letërnjoftimit të vlefshëm, të nënshkruar prej çdo zgjedhësi¹, është ai që **vetë kryetari i KZAZ nuk ka lënë asnjë shënim në lidhje me këtë fakt në Procesverbalin model KQZ-00-31**. Është pikërisht ky procesverbal me titull “Procesverbal i dorëzimit të dokumentave të kandidimit” që reflekton dokumentet që merren në dorëzim nga KQZ/KZAZ nga çdo subjekt zgjedhor. Në brendësi të këtij procesverbali, te pjesa “Emërtimi i dokumentacionit”, në pikë 1 të tij citohet dokumenti “Formular për mbledhjen e nënshkrimeve të zgjedhësve për mbështetje kandidati Model KQZ-04-01” që sipas nenit 71, pika 2 të K.Zgjedhor, bashkë me nënshkrimin, çdo zgjedhës depoziton edhe fotokopjen e letërnjoftimit, të nënshkruar prej tij, e cila i bashkëngjitet listës. **Në kuptim të kësaj dispozite, lista dhe fotokopjet e letërnjoftimeve, konsiderohen një dokument i vetëm**. Në rastin objekt shqyrtimi, lista e mbështetësve, përbëhej nga 215 zgjedhës, çka do të thotë se bashkëlidhur formularit duhet të ishin 215 fotokopje letërnjoftimesh, mungesa e të cilave në momentin e dorëzimit është lehtësisht e identifikueshme për shkak të sasisë së fletëve. **Fakti që një mungesë e tillë nuk është reflektuar në asnjë pjesë të procesverbalit të sipërcituar, madje as në rubrikën “Vërejtje” që do të ishte rasti klasik kur duhet të ishte cituar mungesa e letërnjoftimeve, e bën këtë procesverbal të konsiderohet akt zyrtar në kuptim të nenit 253 të K.Pr.Civile që parashikon se “Aktet zyrtare që përpilohen nga nëpunësi i shtetit ose personi që ushtron veprimtari publike, brenda kufijve të kompetencës së**

¹ Neni 71 pika 2 fjalia e dytë e K.Zgjedhor

tyre dhe në formën e caktuar, përbëjnë provë të plotë të deklarimeve që janë bërë përpara tyre për faktet që kanë ngjarë në prani të tyre ose për veprimet e kryera prej tyre. Lejohet të provohet e kundërta vetëm kur pretendohet se shkresa është e falsifikuar”. Po ashtu, neni 254 i këtij kodi parashikon se “Aktet zyrtare që dalin nga organet shtetërore dhe që përmbajnë një urdhër, një vendim ose çdo masë tjetër të marrë prej tyre ose që tregojnë kryerjen e një veprimi nga ana e këtyre organeve, përbëjnë provë të plotë për përmbajtjen e tyre. Lejohet të provohet e kundërta vetëm kur pretendohet se shkresa është e falsifikuar”. Për sa më sipër, ky procesverbal, përbën provë të plotë në lidhje me dokumentacionin e dorëzuar nga ankimuesi në këtë shqyrtim administrativ, dokumentacion për të cilin kryetari i KZAZ nr, 82 nuk ka pasur asnjë vërejtje.

7. Argumenti i mësipërm nuk mund të rrëzohet me dëshminë e z. Arjan Gjini. Për aq kohë sa sipas arsytimit të mësipërm, Procesverbali model KQZ-00-31 përbën provë të plotë, në zbatim të fjalisë së parë të nenit 232 të K.Pr.Civile që parashikon se “Nuk lejohet prova me dëshmitarë kundër ose tej përmbajtjes së një akti zyrtar ose privat që përbën provë të plotë”, nuk duhet të ishte lejuar prova me dëshmitar në favor të një prapësimi që bie ndesh me një akt zyrtar që përbën provë të plotë në lidhje me dokumentacionin e dorëzuar nga ankimuesi në KZAZ. Ndaj dëshmia e tij, që çënoi dhe rregulla të tjera në lidhje me dëshminë, sidomos mungesa e betimit përpara dhënies së dëshmisë, apo prania e tij në seancë gjatë gjithë zhvillimit të saj deri para dhënies së dëshmisë, e bëjnë atë të papërdorshme.
8. Argumenti i dytë që shkon në favor të ankimuesit në lidhje me posedimin dhe dorëzimin prej tyre të fotokopjeve të letërnjoftimeve të zgjedhësve që mbështesin kandidatin e këtij subjekti zgjedhor për kryetar të Bashkisë Dropull, është ai që në datën 29.03.2023, kur është regjistruar kërkesa ankimore në KQZ, së bashku me kërkesën ankimore dhe dokumentacionin tjetër të kandidimit, ankimuesi ka depozituar edhe 215 fotokopje të nënshkruara të letërnjoftimeve të zgjedhësve mbështetës. Nëse i referohemi nenit 73 pika 1 të K.Zgjedhor që parashikon se “1. KQZ-ja ose, sipas rastit, KZAZ-ja verifikon rregullsinë e dokumentacionit të kandidimit dhe nëse vëren parregullsi apo mospërmbushje të kërkesave të këtij Kodi, **ia kthen ato subjekteve zgjedhore për korrigjim jo më vonë se 45 ditë përpara datës së zgjedhjeve**”, arrijmë në përfundimin se edhe sikur ta konsiderojmë të mirëqenë faktin që fotokopjet e letërnjoftimeve nuk kanë qenë pjesë e dokumentacionit të depozituar në KZAZ, fakti që ato janë depozituar

në KQZ 46 ditë përpara datës së zgjedhjeve, KAS duhet ta konsideronte të përmbushur këtë element për efekt dokumentacioni.

9. Po ashtu, ne anëtarët në pakicë, nuk biem dakord me arsyetimin e shumicës së anëtarëve se *“Kompetencën për kthimin për plotësim të dokumentacionit nuk e ka përfaqësuesi i KZAZ-së që merr në dorëzim dokumentacionin, por e ka KZAZ-ja si trupë. Kthimi për plotësim nuk formalizohet me një akt të caktuar, por formalizohet me një shënim në librin e protokollit të mbledhjeve të KZAZ-së. Në çështjen objekt shqyrtimi, ky shënim është bërë në librin e protokollit të mbledhjeve të KZAZ-së, pas mesnatës së datës 27.03.2023”*, pasi me **Procesverbalin model KQZ-00-31** nuk pretendohet të bëhet shqyrtimi i dokumentacionit, por duhet të bëhet verifikimi sasior në lidhje me dokumentet e dorëzuara dhe të bëhet shënimi përkatës në formën e *“vërejtjes”* për ato dokumente që palët nuk dakordësojnë bashkërisht nëse janë apo jo pjesë e dokumentacionit të dorëzuar.
10. Në lidhje me elementin tjetër të prapësuar nga anëtarët e KZAZ gjatë shqyrtimit administrativ, që ka të bëjë me procedurën e verifikimit të nënshkrimeve në zbatim të nenit 71 pika 3 të K.Zgjedhor, duket qartë që procedura e ndjekur prej tyre shkon tej kërkimeve të parashikuara në K.Zgjedhor. Më konkretisht, në këtë dispozitë parashikohet se *“3. Verifikimi i nënshkrimeve për zgjedhjet për Kuvendin kryhet nga administrata e KQZ-së dhe për zgjedhjet e organeve të qeverisjes vendore kryhet nga KZAZ-ja përkatëse, duke verifikuar 5 për qind të listës mbështetëse të kërkuar sipas ligjit, nëse janë zgjedhës me vendbanim në zonën zgjedhore përkatëse në momentin e depozitimit. Pas verifikimit administrata paraqet një raport të detajuar mbi mangësitë e konstatuara. Raporti shqyrtohet në seancë publike, në prani të palës së interesuar. KQZ-ja vendos për pranimin ose refuzimin e listës mbështetëse. Lista pranohet kur numri i nënshkrimeve mbështetëse, duke përjashtuar numrin e nënshkrimeve të parregullta, është të paktën sa numri minimal i kërkuar për nënshkrimet, sipas këtij Kodi”*. Nga vetë prapësimet e anëtarëve të KZAZ rezulton se ata kanë dështuar të provojnë nëse zgjedhësit nënshkruan për të cilët ata kanë marrë iniciativën për t’i verifikuar janë apo jo zgjedhës të Bashkisë Dropull (si i vetmi verifikim që duhet të bëhet prej tyre), pasi një element i tillë nuk mund të verifikohet me telefonata, por vetëm duke kërkuar informacion nga zyra e gjendjes civile që është dhe organi përgjegjës për përgatitjen e listave të zgjedhësve në zbatim të nenit 49 të K.Zgjedhor. Megjithatë edhe verifikimi ekstraligjor që ka zhvilluar KZAZ nr. 82,

sërish nuk ka ndjekur procedurën e përcaktuar nga K.Zgjedhor pasi vetë KZAZ, përveç shënimeve në Librin e Protokollit të Mbledhjeve, nuk ka prodhuar asnjë raport të detajuar mbi mangësitë e konstatuara prej tyre, raport këtë që duhet ta kishte shqyrtuar në seancë publike, në pranë të subjektit zgjedhor “Nisma Thurje”. Po ashtu, këtu vlen për t’u theksuar, që Komisioni Rregullator pranë KQZ, që ka dhe kompetencën në zbatim të nenit 21 pika 1 shkronja “a” për të nxjerrë aktin normativ të procedurës së verifikimit të nënshkrimeve, nuk e ka nxjerrë një akt të tillë që do të garantonte këtë proces verifikimi për palën e interesuar, në mënyrë që të kishte të drejtën e ankimit veçmas për këtë procedurë siç parashikohet në nenin 71 pika 5 të K.Zgjedhor². **Qartësia e kësaj procedure kërkohet dhe nga “Kodi i Praktikës së Mirë në Çështjet Zgjedhore – Udhëzime dhe Raporti Shpjegues” i miratuar nga Komisioni i Venecias në Mbledhjen e tij 52-të Plenare, i cili në lidhje me paraqitjen e kandidatëve parashikon se “8. Detyrimi për të mbledhur një numër të caktuar firmash për të paraqitur kandidaturën është teorikisht në përputhje me parimin e votimit universal. Në praktikë, vetëm partitë shumë të vogla duket se kanë vështirësi për të mbledhur numrin e caktuar të firmave. Ky detyrim nuk duhet të pengojë kandidatët të vendosin kandidaturat e tyre. Me qëllim që të parandalohet një manipulim i tillë, është e preferueshme që ligji të caktojë një kërkesë maksimale firmash prej 1%³. Procedura e verifikimit të firmave duhet të bëhet mbi bazën e rregullave të qarta, veçanërisht përsa i përket afateve kohore, dhe duhet zbatuar për të gjitha firmat dhe jo vetëm për një kampion të tyre,⁴ megjithatë, kur nga verifikimi është konstatuar përtej çdo dyshimi se numri i kërkuar i firmave është arritur, nuk është e nevojshme të verifikohen firmat e tjera. Në të gjitha rastet, kandidaturat duhet të bëhen të vlefshme përpara fillimit të fushatës zgjedhore, sepse po të bëhet më vonë disa parti dhe kandidatë mund të vihen në disavantazh me partitë e tjera në fushatën zgjedhore”. Për këtë arsye, mungesa e rregullave të qarta në lidhje me verifikimin e mbështetësve, nuk mund të shkojë në disfavor të subjektit zgjedhor, kur për më tepër i vetmi rregull i qartë që është i parashikuar në K.Zgjedhor, ai i verifikimit të faktit nëse mbështetësit e subjektit zgjedhor janë apo jo zgjedhës të Bashkisë Dropull, ka dështuar të verifikohet nga KZAZ edhe pse ky verifikim ka qenë tërësisht i mundur.**

² “5. Në përfundim të procesit të verifikimit të nënshkrimeve KQZ-ja miraton aktin përkatës administrativ, ndaj të cilit mund të bëhet ankim nga subjekti i interesuar në KAS brenda 3 ditëve”.

³ CDL (99) 66, f. 9.

⁴ CDL-INF (2000) 17, f. 4-5; CDL (99) 67, f 7-8.

11. Referuar sa më sipër, mosregjistrimi i kandidatit të paraqitur nga subjekti zgjedhor “Nisma Thurje”, pavarësisht plotësimit të dokumentacionit nga ana e tyre në përputhje me K.Zgjedhor, passjell cënimin e një sërë normave ligjore dhe kushtetuese që janë themelore për funksionimin e demokracisë në vend. Në nenin 1 të ligjit nr. 8580, datë 17.2.2000 “Për partitë politike” i ndryshuar parashikohet se *“Partitë politike janë bashkime vullnetare të shtetasve mbi bazën e ideve, të bindjeve e të pikëpamjeve ose të interesave të përbashkëta politike, të cilët synojnë të ndikojnë në jetën e vendit nëpërmjet pjesëmarrjes në zgjedhjet dhe përfaqësimit të popullit në organet e zgjedhura të pushtetit.”*. Në nenin 3 të po këtij ligji parashikohet se *“Partitë politike shqiptare janë pjesë e një sistemi të lirë e demokratik qeverisës në vend. Krijimi dhe veprimtaria e tyre është e lirë dhe e garantuar nga Kushtetuta.”*. Neni 3 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë që përcakton parimet themelore të saj, parashikon se *“Pavarësia e shtetit dhe tërësia e territorit të tij, dinjiteti i njeriut, të drejtat dhe liritë e tij, drejtësia shoqërore, rendi kushtetues, pluralizmi, identiteti kombëtar dhe trashëgimia kombëtare, bashkëjetesa fetare, si dhe bashkëjetesa dhe mirëkuptimi i shqiptarëve me pakicat janë baza e këtij shteti, i cili ka për detyrë t’i respektojë dhe t’i mbrojë”*. Neni 45 pika 1 i Kushtetutës parashikon se *“Çdo shtetas që ka mbushur tetëmbëdhjetë vjeç, qoftë edhe ditën e zgjedhjeve, ka të drejtën të zgjedhë dhe të zgjidhet.”*
12. Pluralizmi është një nga bazat e shtetit shqiptar dhe ky i fundit ka për detyrë ta respektojë dhe ta mbrojë atë. Po ashtu partitë politike dhe pjesëmarrja e tyre në zgjedhje me kandidatë, janë subjekte dhe procese që gëzojnë mbrojtje kushtetuese për vetë faktin se janë baza e pluralizmit politik në vend. Gjykata Kushtetuese, me vendimin nr. 32, datë 21.06.2010, ka theksuar se *“... pluralizmi është një tërësi rrethanash ku pushteti politik është i shpërndarë në atë mënyrë që asnjë grup interesi ose klasë e caktuar shoqërore të mos mbizotërojë mbi të tjerët. Kushti bazë për pluralizmin janë zgjedhjet e lira, shumësia e interesave, lejimi i hapësirave për organizimin e mekanizmave të presionit ndaj organeve të pushtetit dhe një shtet që është i përgjegjshëm ndaj nevojave të qytetarëve. Në çdo sistem demokratik, përfaqësuesit e popullit në qeverisje zgjidhen përmes zgjedhjeve shumëpartiake, të lira, të barabarta dhe të ndershme”* dhe *“Konkurrimi i lirë ndërmjet partive është një shfaqje e drejtpërdrejtë e natyrës pluraliste të shoqërisë demokratike dhe është pikërisht mbrojtja e pluralizmit në jetën politike që ka kuptim për vetë ekzistencën e kësaj shoqërie. Gjykata thekson se çdo kufizim i drejtpërdrejtë ose i tërthortë mbi barazinë e partive në konkurrimin zgjedhor nuk duhet të ketë një pasojë*

diferencuese ose të përbëjë një trajtim preferencial për disa parti, ose të ndalojë pjesëmarrjen e partive politike në konkurrimin zgjedhor".⁵. Po ashtu, në të njëjtën vendimmarrje të Gjykatës Kushtetuese është cituar se "Në koncept, parimi i konkurimit të lirë të partive politike përfshin detyrimin e shtetit për të respektuar shanset e barabarta të të gjitha partive dhe zbatohet në legjislacionin që rregullon kushtet e këtij konkurimi, si dhe në konfliktet ndërmjet pjesëmarrësve në të. Duke qenë se një efekt i tillë ndikon në respektimin e parimit të barazisë, Gjykata vlerëson se çfarëdolloj ndërhyrjeje nga ligjvënësi mbi këto kushte duhet të udhëhiqet nga interesi publik. Ligjvënësi e ka të ndaluar të trajtojë palët në mënyrë të dallueshme nga njëra-tjetra, përveçse kur ekzistojnë arsye të forta përjashtimore për ta bërë këtë". **Ne anëtarët në pakicë të KAS vlerësojmë se subjekti zgjedhor "Nisma Thurje", së bashku me kandidatin e paraqitur prej saj për kryetar të Bashkisë Dropull, i kanë marrë të gjithë masat e duhura për regjistrimin e kandidatit për kryetar për Bashkinë Dropull, duke konsideruar këtu faktin që dokumentacioni i konsideruar i paplotësuar nga ana e KZAZ, është dorëzuar në KQZ përpara afatit maksimal prej jo më vonë se 45 ditë përpara ditës së zgjedhjeve. Vendimmarrja e KZAZ sa i përket këtij faktit, por dhe mungesës së njohurive për verifikimin e faktit nëse mbështetësit e këtij subjekti zgjedhor janë apo jo zgjedhës të Bashkisë Dropull, nuk mund të çenojë pluralizmin qoftë ky dhe për zgjedhje vendore, ndaj vendimmarrja e KAS duhet të orientohet drejt zgjidhjes për regjistrimin e kandidatit z. Kosta Garo për kryetar të Bashkisë Dropull të paraqitur nga subjekti zgjedhor "Nisma Thurje".**

13. Për sa më sipër, ne anëtarët në pakicë vlerësojmë se kërkesa ankimore e paraqitur nga ankimuesi subjekti zgjedhor "Nisma Thurje" dhe kandidati i saj për kryetar të Bashkisë Dropull, z. Kosta Garo, është e bazuar në ligj dhe ajo duhej të ishte pranuar nga Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve, ndërkohë që duhet të ishte shfuqizuar vendimi nr. 10, datë 28.03.2023 i KZAZ Nr. 82 dhe duhet të detyrohej kjo e fundit që të regjistronte si kandidat për kryetar të Bashkisë Dropull z. Kosta Garo të paraqitur nga subjekti zgjedhor "Nisma Thurje".

Elvis ÇEFA - Relator

Ledio Braho - Anëtar

⁵ CZE-2000-1-002 (Codices).